

Sistemi Zgjedhor në Shqipëri për zgjedhjet e përgjithshme

Sistemi aktual në fuqi që nga viti 2008 është një sistem proporcional rajonal i bazuar në zona zgjedhore me listë shumëëmërore.

- një sistem rajonal proporcional: Kuvendi prej 140 deputete/ësh zgjidhet për një mandat katërvjeçar. Kandidatet/ët zgjidhen nga 12 njësi zgjedhore që korrespondojnë me qarqet administrative. Partitë politike, koalicionet e partive dhe grupet e zgjedhëseve/sve (subjektet zgjedhore) kanë të drejtë të propozojnë kandidatet/ët. Për t'u kualifikuar për shpërndarjen e vendeve në parlament, faktorët politikë duhet të kapërcejnë një prag prej një për qind në mbarë vendin.
- Në bazë të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor në korrik 2024, sistemi në Shqipëri konsiston në: dy forma që rregullojnë strukturën e fletës së votimit: **a) lista shumëëmërore me renditje të fiksuar të kandidateve/ëve; dhe b) lista shumëëmërore e kandidateve/ëve, që i nënshtrohen votimit parapëlqyes.**
 - Në rastin e parë, emrat e kandidateve/ëve të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Numri i përgjithshëm i kandidateve/ëve në listën me renditje të fiksuar është i barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore pjestuar për tre (që do të thotë 1/3 e kandidateve/ëve).
 - Në rastin e dytë, lista shumëëmërore e kandidateve/ëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes nga zgjedhëset/it është e barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore. Renditja e kandidateve/ëve bëhet sipas rendit alfabetik të mbiemrit për secilën/in prej tyre. Kandidatja/i për deputet, e/i regjistruar në listën shumëëmërore me renditje të fiksuar të partisë politike apo koalicionit nuk mund të jetë njëkohësisht edhe në listën shumëëmërore të kandidateve/ëve për deputete/ë që i nënshtrohen votimit parapëlqyes.

Amendamentet e vitit 2024 ndryshuan sistemin e mëparshëm, i cili konsistonte vetëm në votimin preferencial, ku votueset/it mund të zgjidhnin midis partisë ose koalicionit të tyre të preferuar, si dhe të votonin për kandidatin/in e tyre të preferuar nga lista e zgjedhur, gjë që i lejoi votueset/it të ndikonin potencialisht në renditjen e të gjithë kandidateve/ëve në listë.

Pas procesit të votimit, përdoret një formulë për përllogaritjen dhe shpërndarjen e mandateve për kandidatet/ët fitues/e, bazuar në votat e marra në çdo qark. Mandatet për kandidatet/ët fitues fillimisht shpërndahen sipas renditjes së listës shumëëmërore me renditje të fiksuar të subjektit zgjedhor dhe në përputhje me renditjen e kandidateve/ëve në të. Në rast shterimi të saj, shpërndarja vijon me kandidatet/ët fitues të rirenditur të listës shumëëmërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes, në bazë të numrit më të lartë të votave të marra nga secili/a kandidat/e.

Nga ana tjetër, amendamentet e vitit 2024 sigurojnë votën e shtetaseve/ve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, gjë që konsiderohet një arritje e madhe për sistemin demokratik në Shqipëri.

Burimi: KQZ/UNWomen. Informacion paraprak mbi proceset zgjedhore në Shqipëri